



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretarët e Përgjithshëm të: MF, MD	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 30/12/2019 Nr.43-1293/1
Zyrtari përgjegjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave.	
Komisioni ndërministror për hartimin dhe vlerësimin e aktit	Sanije Dërguti, MAPL Razije Murtezaj MF Ardian Mehmeti MD	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	


I nderuar Kryetar,  
I nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore për taksa komunale
E miratuar më datë: 20.12.2019
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.12.2019

Komisioni Nderministror i formuar nga MAPL, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

Za:	Imri Ahmeti, gradonačelnik Opštine Lipljan Daut Azemi, predsedavajući Skupštine opštine Lipljan	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentavije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini Pravno odeljenje i monitorisanje opština /MALS	
Preko:	ZA: Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, <i>B. K...</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u, <i>Rozafa Ukimeraj</i>	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS <i>Venera Çerkini</i>	Datum, 30.12.2019. Br. 43/1293/1
Odgovorni službenik:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za minitorisanje opština <i>Xhevat Tafa</i>	
Međuministarska komisija za izradu i ocenjivanje akta	Sanije Dërguti, MALS <i>S. Dërguti</i> Razije Murtezaj MF Ardian Mehmeti MP <i>A. Mehmeti</i>	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Lipljan	
Vrsta akta:	Uredbo Skupštine opštine Lipljan	

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvaženi predsedavajući,


U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku :

Uredba o opštinskim taksama
Usvojena dana, 20.12.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 23.12.2019. godine

Međuministarska komisija formirana od strane MALS-a, Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocemjuje da je opštinski akt u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravnu efekat.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**  
**Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave**  
**Ministry of Local Government Administration**

Për:	Naim Baftiu, i Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë	
Kopje:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 24/12/2019 Nr. 43-1293
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të për përcjelljen e aktit Komunave në Ministri të Linjës 2. Zyrtari përgjegjës Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për Monitorim të për hartimin e Komunave shkresës përcjellëse	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit,	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës së Lipjanit	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar "Rregullore për taksat komunale" e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Rregullore për taksat komunale  
 E miratuar më datë: 20.12.2019  
 E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.12.2019




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Në bazë të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 8, 12 deri në 16 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.2008 neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 si dhe në Kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e ligjshmërisë së së aktit të Komunës së Lipjanit Nr.43-1200/2 të datës 13.12.2019, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 20. 12. 2019, pas shqyrtimit të propozim Rregullores të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

## RREGULLORE PËR TAKSAT KOMUNALE



### I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

#### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të Rregullores për taksat komunale (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal.

#### Neni 2 Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohen taksat komunale nga kompetenca e komunës, obliguesit, procedura e pagesave si dhe procedura e ankesave, si vijon:

1. Taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare ,
2. Taksa për pronësinë e automjeteve motorike,
3. Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike,
4. Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Rini, Sport dhe Kulturë.
5. Taksa për rendin e udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus,
6. Taksa për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë auto-taksi



- 7. Taksat për shfrytëzimin e parkingjeve për automjete taksi,
- 8. Taksa për antena të telefonisë mobile dhe të internetit,
- 9. Taksa për përçojat e vendosura në pronën komunale.

#### Neni 3

#### Taksat tjera dhe bashkëpagesat

1. Taksat administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore do të përcaktohen me vendim të veçantë, në pajtim me procedurat e parapara me nenin 22 të Ligjit Nr.04/L-110 për ndërtim Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.18 e datës 03.07.2012 dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.
2. Taksat tjera të përcaktuara me dispozita ligjore, bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi, tarifat për shërbimet dhe produktet kadastrale, taksat për regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtëshme, të cilat sipas kompetencës i përcaktojnë Ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të aplikohen nga organet e Komunës në pajtim të dispozitave ligjore dhe udhëzimeve përkatëse administrative.

#### Neni 4

#### Fushëveprimi

Taksat e përcaktuara me këtë rregullore i zbatojnë organet e administratës dhe institucionet tjera komunale, nëse me dispozita ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.

#### Neni 5

#### Obliguesit

Obligues për pagesën e taksave të përcaktuara me këtë rregullore janë personat fizik dhe juridik me rastin e parashtrimt dhe zgjidhjes së kërkesave të tyre nga fushëveprimi i organeve të administratës dhe institucioneve të Komunës.

## II. TAKSAT

#### Neni 6

#### Taksat administrative për lëshimin e dokumenteve zyrtare

1. Këto taksa i aplikojnë organet e administratës dhe institucionet e Komunës me rastin e parashtrimt të kërkesave të personave fizik dhe juridik për lëshimin e dokumenteve zyrtare, si vijon:

Nr	EMËRTIMI I DOKUMENTIT	SHUMA
1	Ekstrakti dhe certifikata e lindjes, certifikata e martesës dhe vdekjes, certifikatat dhe vërtetimet tjera, nëse me akte tjera dhe këtë Rregullore nuk është përcaktuar shumë tjetër e taksës	1 €

2	Certifikata për gjendjen martesore	2 €
3	Aktvendimi për ndërrimin e emrit personal	10 €
4	Aktvendimet për regjistrime të mëvonëshme në Regjistrat e Gjendjes Civile	2 €
5	Korigjimet e shënimeve në Regjistrat e Gjendjes Civile	2 €
6	Certifikata për bashkësinë familiare	2 €
7	Akt vdekjeje	0 €
8	Ceremonia e kurorëzimit në Zyrën e Komunës	10 €
9	Ceremonia e kurorëzimit jashtë Zyrës së Komunës	80 €
10	Vërtetim për mbajtës të familjes	4 €
11	Vërtetim për shtesa të fëmijëve jashtë vendit	4 €
12	Lëshimi i duplikatit nga dokumenti origjinal që e posedon organi komunal i administratës, përkatësisht institucioni i Komunës, nëse me dispozitë tjetër nuk është përcaktuar ndryshe	3 €
13	Lëshimi i kopjeve të dokumenteve që i posedon Arkivi, për çdo faqe të shkruar nga	0.50 €
14	Pjesëmarrja në Ankand për dhënien në shfrytëzim afatshkurt të tokës në pronësi të Komunës	20 €
15	Pjesëmarrja në Ankand për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës në pronësi të Komunës	50 €
16	Pjesëmarrja në Ankand për shitjen e masës drunore	20 €
17	Pjesëmarrja në Ankand për shitjen e mjeteve themelore	10 €
18	Certifikimi i Objektivit mbi plotësimin e kushteve minimale – teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste – deri në 100 m/2	25 €
19	Certifikimi i Objektivit mbi plotësimin e kushteve minimale – teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste – mbi 100 m/2	50 €
20	Aktvendimet tjera nëse me dispozita tjera dhe këtë Rregullore nuk është përcaktuar shumë tjetër e taksës	3 €

- Nga pagesa e taksave nga paragrafi 1 i këtij neni në numrat rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,10,11,12,13 dhe 20, janë të liruar: anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë, invalidët dhe veteranët e luftës së UÇK-së, shfrytëzuesit e të drejtës të asistencës sociale dhe personat me aftësi të kufizuara të kategorizuar me vendim mjekësor.
- Nga pagesa e taksës në numrin rendor 13 - Lëshimi i kopjeve të dokumenteve që i posedon Arkivi, për çdo faqe të shkruar nga 0.50 €, janë të liruar pensionistët.
- Lirimi nga pagesa e taksave nga paragrafi 2 i këtij neni bëhet në bazë të prezantimit të dokumentit përkatës të prezentuar nga parashtruesi i kërkesës.

#### Neni 7

Kërkesat dhe aktet zyrtare për të cilat nuk do të bëhet pagesa e taksës



Nuk do të aplikohet taksa për kërkesa dhe vendime, nëse me dispozita tjera nuk është përcaktuar ndryshe, si vijon:

- për punësim dhe nga marrëdhënia e punës,
  - për njohjen e të drejtave nga asistenca sociale dhe ndihmë momentale sociale,
  - për trajtim shëndetësor,
  - për subvencione sipas Rregullores komunale për subvencionet,
  - për vërtetime mbi pagesën e tatimit në pronë,
  - për parashtrësia dhe peticione lidhur me punën e organeve komunale,
  - për kundërshtime dhe ankesa sipas vendimeve të organeve komunale,
  - për kërkesa dhe vendime për kryerjen e praktikës profesionale
  - për kërkesa dhe hulumtime shkencore dhe
  - për kërkesa dhe parashtrësia për ndërmarrjen e veprimeve të mbikëqyrjes inspektive.
  - për kërkesa dhe parashtrësia për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për realizimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter edukues, human apo të ngjashme për ndonjë ditë të caktuar.
- si regjistruara tregtare, dhe shoqatat joqeveritare që kanë selinë në Komunë.

#### Neni 8

##### Taksa për pronësinë e automjeteve motorike

1. Obligues të taksës për pronësinë e automjeteve motorike janë pronarët e automjeteve motorike: personat fizik të cilët janë banorë të Komunës, shoqëritë e regjistruara tregtare, dhe shoqatat joqeveritare që kanë selinë në Komunë.
2. Kjo taksë përcaktohet dhe paguhet në shumë vjetore me rastin e regjistrimit të automjeteve, si vijon:

Nr.	Lloji i automjetit	Taksa
1	Automjetet me peshë deri në 3.5 tonë	10 €
2	Automjetet me peshë mbi 3.5 tonë	20 €

3. Të liruar nga pagesa e kësaj takse për automjetet që i kanë në pronësi, janë:

Organizata e veteranëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së, Shoqata e familjeve të dëshmorëve të luftës të UÇK-së, Kryqi i kuq Komunal, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, anëtarët e ngushtë të familjeve të viktimave civile të luftës së fundit në Kosovë, invalidët e luftës së UÇK-së, veteranët luftëtar të UÇK-së dhe shoqatat për përkujdesje të personave me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara të kategorizuar me vendim mjekësor.

#### Neni 9

##### Taksa për vendosjen e objekteve lëvizëse në sipërfaqet publike

1. Këtë taksë e aplikon Drejtorati i Shërbimeve Publike për dhënien e lejeve për shfrytëzim sezonal në kohëzgjatje jo më shumë se një vit të hapësirave publike në pronësi të Komunës për vendosjen e objekteve lëvizëse.

2. Lartësia e obligimit përcaktohet për kohëzgjatjen e shfrytëzimit të sipërfaqes publike e përcaktuar në lejen për shfrytëzim për objektet lëvizëse, si vijon :

Nr.	EMËRTIMI DHE VEPRIMTARIA	BAZA	SHUMA
1	Paisjet për shitjen e akulloreve, pijeve freskuese, duhanit, pofkave, misrit, gështenjave dhe të ngjashme. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m <sup>2</sup>	5 €
2	Shfrytëzimi i sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarinë e cila është e lejuar të ushtrohet edhe jashtë objektit dhe për ekspozimin e mallrave të lejuara. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore.	m <sup>2</sup>	1 €
3	Konstruksionet për lojëra dhe të lunaparqeve. Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m <sup>2</sup>	0.50 €
4	Tavolinat lëvizëse për shitjen e urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, bjizhuterive, gjërave dekorative, mjeteve piroteknike CD- kasetave dhe të ngjashme Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m <sup>2</sup>	1 €
5	Promovimi i produkteve të biznesit. Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m <sup>2</sup>	0.50 €
6	Vendosja e reklamave para objekteve afariste në pronën e komunës. Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore.	m <sup>2</sup>	50 €
7	Aparatet dhe skarat për përgaditjen e produkteve ushqimore, i cili së bashku me shtëpizën e aparatit, nuk kalon sipërfaqen prej 2m <sup>2</sup> . Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m <sup>2</sup>	10 €
8	Automjete lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë, automjet i veçantë i atestuar për kryerjen e veprimtarisë për shitjen e ushqimit të shpejtë. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m <sup>2</sup>	20 €
9	Vendosja e muraleve në fasadat e ndërtesave . Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m <sup>2</sup>	30 €
10.	Ekranet dhe reklammat elektronike. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m <sup>2</sup>	50 €
11.	Vendosja e gjeneratorëve në sipërfaqen publike. Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	m <sup>2</sup>	50 €
12.	Vendosja e kabinave telefonike.Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore.	m <sup>2</sup>	100 €



3. Nga pagesa e taksës në numrin rendor 4- Tavolinat lëvizëse për shitjen e urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, bizhuterive, gjërave dekorative, mjeteve piroteknike CD-kasetave dhe të ngjashme, janë të liruar shitësit e librave.

4. Të liruar nga pagesa e taksës në numrin rendor 5 të paragrafit 2 të këtij neni - Promovimi i produkteve biznesit janë organizatat e ndryshme joqeveritare joprofitabile të cilat kanë parashtruar kërkesë pranë organeve kompetente komunale dhe i është lejuar promovimi i produkteve të tyre në formë panairi apo të ngjajshme për ndonjë ditë të caktuar.

#### Neni 10

Taksa për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve për Rini, Sport dhe Kulturë

1. Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Rini, Sport dhe Kulturë, me rastin e parashtrimit të kërkesave të subjekteve të regjistruara për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të objekteve për Kulturë, Rini dhe Sport, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shuma
1	Shfrytëzimi i sallave	50 € / h
2	Shfrytëzimi i objekteve sportive	10 € / h

2. Nga pagesa e taksës numër 2 lirohen klubet e Komunës të cilat janë të kualifikuara dhe garojnë në ligat përkatëse sportive.

#### Neni 11

Taksa për ndarjen e rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus

Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike gjatë ndarjes së rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus dhe është 30 € për një rend të udhëtimit. Pagesa vlen për tri vite njëjtë sikur rendet e udhëtimit.

#### Neni 12

Taksa për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë auto-taksi

Këtë taksë e aplikon Drejtorati për Shërbime Publike me rastin kur operatori paguajë me licencë për ushtrimin e veprimtarisë auto-taksi. Taksa është 30 € për një automjet.

#### Neni 13

Taksa për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksit

1. Taksën për shfrytëzimin e parkingjeve për automjetet taksit, janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e licencuar për veprimtarinë autotaksi, për secilin automjet në shumë vjetore në lartësi prej 30 €.

2. Pagesa e parë për vitin kalendarik do të bëhet me rastin e lëshimit të licencës për ushtrimin e veprimtarisë "taksi" dhe caktimin e autoparkingut për vendosjen e automjetit.

3. Drejtorati i Shërbimeve Publike përgatitë faturat për pagesën e kësaj takse në bazë vjetore për 4 vitet tjera në vijim, përkatësisht për kohëzgjatjen e licencës dhe ja dërgon obliguesëve për secilin vit kalendarik, më së largu një muaj para fillimit të vitit të ri kalendarik.

4. Me gjobë në shumë prej 60 € do të dënohet ushtruesi i veprimtarisë autotaksi në rast të moskryerjes së pagesës së taksës së cekur në par. 1 të këtij neni pas pranimit të faturës.

#### Neni 14

##### Taksa për antena të telefonisë mobile dhe të internetit

1. Taksën për vendosjen e antenave të telefonisë mobile janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë të telefonisë mobile për secilën antenë të vendosur në teritorin e Komunës në bazë vjetore në lartësi prej 100 €.

2. Taksën për vendosjen e antenave të internetit janë të obliguar ta paguajnë ushtruesit e veprimtarisë të internetit për secilën antenë të vendosur në teritorin e Komunës në bazë vjetore në lartësi prej 50 €.

3. Për pagesën e obligimeve për vitet në vijim, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e lëshon lejen për vendosjen e antenave të telefonisë mobile dhe atyre të internetit dhe përgatitë faturat dhe ua dorëzon për pagesë ushtruesëve të veprimtarisë për secilin vit kalendarik më së largu një muaj para fillimit të vitit të ri kalendarik.

4. Pagesa e parë për vitin kalendarik do të bëhet me rastin e lëshimit të lejes për vendosjen e antenës telefonike mobile përkatësisht internetit.

#### Neni 15

##### Taksa për përçojat e vendosura në pronën komunale

1. Këtë taksë janë të obliguar ta paguajnë subjektet të cilat kanë vendosur përçojat e rrjetit kabllor, elektrik internet, telefonik në pajtim me lejen përkatëse për vendosjen e tyre të lëshuar nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

2. Taksa për vendosjen e përçojave të cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të jetë 0.10 € për metër gjatësi. Ngarkesa paguhet në bazë vjetore në bazë të faturave të lëshuara nga Drejtoratit për Shërbime Publike .

3. Subjektet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni do të dënohen me gjobë në rast të moskryerjes së pagesës së taksës të cekur në paragrafin 2 të këtij neni pas pranimit të faturës. Gjopa ose sanksioni kundërvajtës do të shqiptohet deri në dyfishin e vlerës së



taksës nëse kjo vlerë e gjohës nuk tejkalon limitet e përcaktuara me dispozitat e nenit 29 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje.

### III. DETYRAT DHE PËRQJEGJËSITË

#### Neni 16

##### Detyrat e organeve dhe institucioneve të Komunës

Organet e administratës dhe institucionet e Komunës, sipas fushëveprimit të tyre, janë të obliguara të zbatojnë dhe të inkasojnë taksat nga personat fizik dhe juridik sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

#### Neni 17

##### Detyrat e obliguesve

Obliguesit kanë për detyrë të paguajnë shumat e caktuara të taksave sipas procedurës dhe afateve të përcaktuara me këtë Rregullore.

### IV. PROCEDURA E ANKESAVE

#### Neni 18

##### Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

Pala e pakënaqur me aktin e Organit të Komunës kompetent për shqyrtimin e kërkesës, me të cilin i përcaktohet shuma e obligimit për pagesë të taksës, mund të parashtojë kërkesë për rishqyrtim sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative .

### I. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 19

##### Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për taksat komunale 15Nr.011-17239 e datës 05.04.2016 dhe Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksat komunale 15 Nr.011-17239 të datës 05.04.2016 e miratuar me datë 15Nr.011-20211/18 me datë 30.03.2018.

Nr.15- 131-2019

Lipjan, më 20. 12. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

43-1200/2  
16-12-2019



Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i kuvendit të Komunës së Lipjanit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretarët e Përgjithshëm të: MF, MMPH, MSH, MD, MKRS, MMPH	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 11/12/2019 Nr.43-1200
Zyrtar përgjegjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave.	
Komisioni ndërmënor për hartimin dhe vlerësimin e aktit	Sanije Dërguti, MAPL Razije Murtezaj MF Sabrije Ramaj MMPH Mirvete Kelmendi MSH Ardian Mehmeti MD Bislim Bislimi MKRS MPMS MPB	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,  
 E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:



Rregullore për taksa komunale

E miratuar më datë: 26.11.2019

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 27.11.2019


Komisioni Nderministror i formuar nga MAPL, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
	Rregullore për taksa komunale	<p>Rregullorja për taksa komunale, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi si vijon:</p> <p><b>Ministria e Drejtësisë;</b> Neni 15, (paragrafi 3) i Rregullores për taksa komunal e komunës së Lipjanit në përcakton sanksion kundërvajtës me gjobë me "dyfishin" e vlerës së taksës përkatëse. Andaj, rekomandojmë që në shqiptimin e kësaj gjobe, Komuna duhet të ketë kujdes se "dyfishi", duhet të jetë brenda limiteve të përcaktuara në nenin 29, (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje</p> <p><b>Ministria e Financave</b> rekomandon të riformulohet neni 18 i rregullores në fjalë si në vijim neni 18, lidhur me kërkesat për rishqyrtim dhe ankesa, nuk është kompetencë e Ministrisë së Financave, por të zbatohet Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Komisioni Nderministror i formuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndër marrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Za:	Imri Ahmeti, gradonačelnik opštine Lipljan Daut Azemi, predsedavajuća Skupštine opštine Lipljan	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenanta u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini Generalnim sekretarima relevantnih ministarstva MF, MSPP, MP, RR, MZ, MP, MONT, MKOS,	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a,	
Od:	Venera Qerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanja opština, MALS	Datum, 11.12.2019.
Odgovorni službenik:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština.	Br.43-1200
Međuministarska komisija za izradu i ocenjivanje akta:	Sanije Dëguti, MALS Razije Murtezaj, MF Sabrije Ramaj, MSPP Mirvete Kelmendi, MZ Ardian Mehmeti, MP Bislime Bislimi, MKOS MRSS MUP	
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Lipljan	
Vrsta akta:	Uredba Skupštine opštine Lipljan	

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmetranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Uredba i opštinskim taksama



Uredba za opštinske takse
Usvojena dana: 26/11/2019. godine
Dostavljena za razmatranje u MALS dana: 27/11/2019.

Meduministarska komisija formirana od strane MALS-a, na osnovu Uredbe Vlade Republike Kosovo br.10/2019 za administrativno razmatranje opštinskih akata, nakon razmatranja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formuliranje u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Uredba za opštinske takse	<p>Uredba o opštinskim taksama, koju je usvojila Skupština opštine Lipjane, u suprotnosti je sa odredbama važećeg zakonodavstva, kao u nastavku:</p> <p>Ministarstvo pravde;            Član 15 (stav 3) Uredbe za opštinske takse opštine Lipjane definiše prekršajnu kaznu novčanom kaznom u „duploj“ vrednosti dotičnog poreza. Stoga, preporučujemo da prilikom izricanja ove novčane kazne Opština treba imati na umu da bi „dvostruki“ iznos trebao da bude u granicama utvrđenim u članu 29. (stavovi 4 i 5) Zakona br. 05 / L-087 o prekršajima.</p> <p>Ministarstvo finansija preporučuje da se član 18 navedene uredbe preoblikuje na sledeći način            Član 18, u vezi sa zahtevima za ponovno razmatranje i žalbe, nije u nadležnosti Ministarstva finansija, već da se primenjuje Zakon br. 05 / L -031 o opštem upravnom postupku.</p>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave *traži* od Skupštine opštine/ gradonačelnika opštine da preuzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana dostavljanja zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



03-1200/1

03.12.2017

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për:	Naim Baftiu, i Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave Lulzim Ejupi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme Qemajl Mammullakaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Veton Firzi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.	
Kopje:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Data: 02/12/2017 Nr: 43-1200
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Sanije Dërguti, Zytare e lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligshmërisë së aktit të Komunës së Lipjanit.	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës së Lipjanit	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar "Rregullore për taksat komunale" e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.



Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve në Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Rregullore për taksat komunale

E miratuar më datë: 26.11.2019

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 27.11.2019

*Të nderuar ashtu siç parashihet në Nenin 7 paragrafi 7 i Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave si dhe vendimit të sekretares së MAPL-së Nr. 02/1097 miratuar më 31.10.2019, ju lutem që ti caktoni zyrtaret të cilët do jenë në dukim për të shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e këtij akti ashtu siç parashihet në këtë rregullore.*

## Sanije Dërguti

---

**From:** Razije Murtezaj  
**Sent:** Monday, December 30, 2019 11:42 AM  
**To:** Sanije Dërguti  
**Subject:** RE: Shkresë përcjellëse nga MAPL

E nderuar,

Une jam ne pushim vjetor, per hire te korreksise une e analizova Rregulloren ne fjale, nuk kam ndonje koment.

Ndersa per nenshkrim, une dale ne pune me date 08.01.2020, jemi ne kontakt.

Me respekt,  
Razije Murtezaj

Sent from my Samsung Galaxy smartphone.

----- Original message -----

**From:** Sanije Dërguti <Sanije.Derguti@rks-gov.net>  
**Date:** 27/12/2019 14:04 (GMT+01:00)  
**To:** Ardian Mehmeti <Ardian.Mehmeti@rks-gov.net>, Razije Murtezaj <Razije.Murtezaj@rks-gov.net>  
**Cc:** Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>  
**Subject:** FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

I/e nderuar,

Të bashkangjitur gjeni shkresën përcjellëse për vlerësimin e rregullores së Kuvendit të Komunës së Lipjani. Ju lutem vlerësojeni dhe mi dërgoni komentet deri të Hënën me datë: 30.12.2019, në ora 13:00, në mënyrë që të Martën ta përgatiti për nënshkrim nga ana e juaj (për arsye të festave dhe ecjes së afatit), dhe të procedojmë brenda afatit ligjor.

Me respekt,  
Sanije Dërguti

---

**From:** Shkrimorja Mapl  
**Sent:** Friday, December 27, 2019 11:40 AM  
**To:** Aferdita Shehu; Bashkim Hajdini; Naser R. Haziri; Qemajl Marmullakaj; Xheladin Krasniqi; Ibadete Qehaja  
**Cc:** Imri Ahmeti; Kumrije Reqica; Burim H. Gashi; Sibel Gutiq; Mimoza S. Morina; Aurora Kadriu; Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Sanije Dërguti  
**Subject:** Shkresë përcjellëse nga MAPL



## Sanije Dërguti

---

**From:** Ardian Mehmeti  
**Sent:** Friday, December 27, 2019 11:17 PM  
**To:** Sanije Dërguti  
**Cc:** Ardian Bajraktari; Floriana Rugova  
**Subject:** RE: Shkresë përcjellëse nga MAPL

E nderuar,

Komentet e Ministrisë së Drejtësisë janë pranuar dhe tani Projekt Rregullorja në fjalë sa i përket fushës tonë konfirmoj se është në rregull.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Ardian Mehmeti  
Ministria e Drejtësisë

Sent from my Samsung Galaxy smartphone.

----- Original message -----

**From:** Sanije Dërguti <Sanije.Derguti@rks-gov.net>  
**Date:** 12/27/19 14:04 (GMT+01:00)  
**To:** Ardian Mehmeti <Ardian.Mehmeti@rks-gov.net>, Razije Murtezaj <Razije.Murtezaj@rks-gov.net>  
**Cc:** Vjosa Ahmetaj <Vjosa.Ahmetaj@rks-gov.net>  
**Subject:** FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL

I/e nderuar,

Të bashkangjitur gjeni shkresën përcjellëse për vlerësimin e rregullores së Kuvendit të Komunës së Lipjani. Ju lutem vlerësojeni dhe mi dërgoni komentet deri të Hënën me datë: 30.12.2019, në orë 13:00, në mënyrë që të Martën ta përgatiti për nënshkrim nga ana e juaj (për arsye të festave dhe ecjes së afatit), dhe të procedojmë brenda afatit ligjor.

Me respekt,  
Sanije Dërguti

---

**From:** Shkrimorja Mapl  
**Sent:** Friday, December 27, 2019 11:40 AM  
**To:** Aferdita Shehu; Bashkim Hajdini; Naser R. Haziri; Qemajl Marmullakaj; Xheladin Krasniqi; Ibadete Qehaja  
**Cc:** Imri Ahmeti; Kumrije Reqica; Burim H. Gashi; Sibel Gutiq; Mimoza S. Morina; Aurora Kadriu; Venera Çerkini; Xhevat Tafa; Sanije Dërguti  
**Subject:** Shkresë përcjellëse nga MAPL